



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR
PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGJENCISË SE SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2018

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 6 Maj 2019, mori në shqyrtim raportimin vjetor dhe veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për vitin 2018.

Komisioni, bazuar në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi çështjen në përputhje me rendin e ditës dhe kalendarin e punimeve të tij.

Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave paraqiti zhvillimet kryesore të veprimtarisë së Agjencisë gjatë vitit të mëparshëm në zbatim të detyrimeve ligjore si rregullator dhe administrator i skemës së sigurimit të depozitave si dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Relatori Ervin Bushati, bëri vlerësimin për veprimtarinë njëvjeçare të institucionit si dhe rekomandimet për drejtimet kryesore ku duhet të përqendrohet Agjencia përgjatë vitit 2018.

Në fund, Kryetari i Komisionit zoti Arben Ahmetaj, bëri një përmbledhje duke evidentuar faktin që 96 % e depozitave të shqiptarëve, janë plotësisht të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave.

Në përfundim të mbledhjes,

- **Në përfundim**, mbështetur në nenin 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm miratoi projektrezolutën për veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018, që i bashkëlidhet këtij Raporti dhe i përcillet seancës plenare për votim.

Relator
Ervin BUSHATI

KRYETAR
Arben AHMETAJ